

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr.4 Tiranë

PROGRAM

I KURSIT TË VEÇANTË **“KUJDESTARI PËR TË MOSHUAR”**

Kodi: KM-22

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“KUJDESTARI PËR TË MOSHUAR”

(Kodi: KM-22)

I. Profili profesional i kujdestarit për të moshuar.

a) Karakteristikat kryesore të kujdestarit për të moshuar.

Kujdestari për të moshuar do të jetë i aftë të kryejë detyra që lidhen me kujdesin personal dhe social të personave të moshuar pranë institucioneve shtetërore ose private që ofrojnë shërbime sociale, ose të ofrojnë kujdes personal në shtëpi. Kujdestari për të moshuar, do të angazhohet në shërbime apo detyra që e ngarkojnë atë jo vetëm me përgjegjësi të madhe individuale, por edhe me përdorimin e shprehive specifike intelektuale për të zbatuar në mënyrë sa më konkrete dhe korrekte programe të përkujdesjes psiko-sociale.

Për realizimin me sukses të detyrave të mësipërme, kujdestari për të moshuar duhet të zotërojë njohuri që kanë të bëjnë me etikën profesionale, me respektimin e të drejtave të njeriut, me standartet e shërbimeve sociale, me konceptete bazë të legjislacionit të shërbimeve sociale etj., por jo vetëm, kujdestari për të moshuar duhet të zotërojë shprehje profesionale që kanë të bëjnë me: ndihmën e parë, me kujdesjen trupore personale, me zbatimin e procedurave të ushqyerjes, të zhveshjes-veshjes, të larjes, të dhënies së medikamenteve, etj., individëve të moshuar.

Suksesi i kujdestarit për të moshuar është i lidhur ngushtë dhe me sjellje (qendrim) të tilla si: të qenit i disiplinuar, i ndershëm, i durueshëm, i vetëkontrolluar, i kujdesshëm, korrekt dhe të ketë aftësi të mira komunikimi etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e kujdestarit për të moshuar.

Profesioni i kujdestarit për të moshuar është i lidhur ngushtë me shërbimet sociale ndaj individëve të moshuar, të cilat kryhen në institucioneve shtetërore ose private që ofrojnë keto shërbime, ose shërbime që ofrojnë kujdes personal në shtëpi. Kështu, kujdestari për të moshuar mund të punësohet në qendra rezidenciale ose ditore të përkujdesjes për të moshuar, në shërbimet komunitare të përkujdesjes, në spitale, apo të përfshihet në shërbime pranë familjeve. Kujdestari për të moshuar mund të vetëpunësohet, duke krijuar biznesin social, duke punësuar kështu dhe të tjerë, sigurisht që kjo kërkon kualifikime të mëtijshme dhe eksperiencë profesionale. Kujdestari për të moshuar i ka mundësitë për të përparuar në profesion duke kaluar në faza të ndryshme, ai/ajo mund të angazhohet me sukses dhe në fusha të përafërta, si infermieri, ose punonjës social etj., sigurisht që këto kërkojnë përvojë pune dhe arsimim e trajnim të vazhdueshëm.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Kujdestari për të moshuar”.

Në përfundim të Kursit për Kujdestari për të moshuar, kursantët do të jenë të aftë të:

- të zbatojnë etikën profesionale të kujdestarit për të moshuar;
- të respektojnë të drejtat e të moshuarit;
- të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit të shërbimeve sociale;
- të zbatojnë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit;
- të përshkruajnë aspektet sociale dhe nevojat e individëve të moshës së tretë;
- të japë ndihmën e parë individëve të moshuar;
- të kryejnë përkujdesjen trupore personale për individët e moshuar;

- të kryejnë zhveshjen, larjen, veshjen e individëve të moshuar;
- të ndihmojnë individët e moshuar gjatë të ushqyerit dhe marrjes së medikamenteve;
- të zbatojnë rregullat e higjienës, pozicionimin dhe lëvizjen e individëve të moshuar;
- të kryejnë gjimnastikën dhe procedurat e rekomanduara për të moshuarit;
- të ndërtojnë marrëdhënie profesionale me familjarët e të moshuarit;
- të përcaktojnë rolin dhe përkujdesjen e të moshuarit në shërbimet familjare;
- të planifikojnë dhe të përkujdesen për të moshuarin në banesë, pranë familjes.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Kujdestari për të moshuar”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Kujdestari për të moshuar” duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Kujdestari për të moshuar”.

250 orës mësimore, ku

1 orë mësimore = 45

V. Modulet e Kursit “Kujdestari për të moshuar”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e kujdestarit për të moshuarit.	KM -01-22	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan vecoritë e profesionit të kujdestarit për të moshuar. 2. Kursanti përcakton rolin, rëndësinë dhe detyrat e kujdestarit për të moshuar, në shërbimet sociale për të moshuarit. 3. Kursanti përshkruan ndryshimet specifike gjatë plakjes dhe standartet e kujdesit për të moshuar.
2	Vlerësimi i gjëndjes dhe përkujdesja psiko-sociale e të moshuarve.	KM -02-22	60 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti planifikon përkujdesjen psiko-sociale të të moshuarit. 2. Kursanti vlerëson nevojat e të moshuarve. 3. Kursanti përkujdeset për shëndetin mendor të të moshuarit. 4. Kursanti mbështet të moshuarin për autonomi. 5. Kursanti asiston dhe mbështet të moshuarin gjatë ndryshimeve sociale. 6. Kursanti përkujdeset për të moshuarin gjatë dhe pas vdekjes.

3	Dhënia e ndihmës së parë tek të moshuarit	KM -03-22	30 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti vlerëson gjëndjen dhe të dhënat shëndetësore të të moshuarit. 2. Kursanti vlerëson shenjat jetësore tek të moshuarit. 3. Kursanti i jep të moshuarit ndihmën e parë sipas rastit.
4	Përkujdesja personale, zbatim i rregullave të higjienës dhe dhënia e medikamenteve të rekomanduara.	KM -04-22	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen zhveshjen e të moshuarve. 2. Kursanti përkujdeset për pjesë të ndryshme të trupit të të moshuarit. 3. Kursanti kryen larjen e të moshuarit. 4. Kursanti kryen veshjen e të moshuarit. 5. Kursanti zbaton rregullat e higjienës për parandalimin e infeksioneve. 6. Kursanti ushqen të moshuarin. 7. Kursanti i jep të moshuarit medikamentet e rekomanduara.
5	Pozicionimi, lëvizja e të moshuarit dhe gjimnastika shëruese.	KM -05-22	30 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti pozicionon të moshuarin për parandalimin e dekubitusit dhe kontrakturave. 2. Kursanti pozicionon të moshuarin për parandalimin e pneumonive dhe trombozave. 3. Kursanti zbaton gjimnastikën dhe procedura rehabilituese.
6	Përkujdesja për të moshuarit në banesë, pranë familjeve	KM -06-22	30 orë mësimore Rekomandohet: 40% Teori 50% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përcakton rolin dhe rëndësinë e shërbimit të përkujdesjes në familje. 2. Kursanti planifikon përkujdesjen në familjen e të moshuarit. 3. Kursanti përkujdeset për të moshuarin në familje.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Kujdestari për të moshuar”:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e kujdestarit për të moshuar”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E KUJDESTARIT PËR TË MOSHUAR.	KM-01-22
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh kursantët me e rolin dhe veçoritë e kujdestarit për të moshuar, me përfshirjen e tij në shërbimet sociale, familjare, komunitare, me identifikimin e shërbimeve sociale për të moshuarit, si dhe i njeh me konceptet bazë të legjislacionit në mbrojtje të individëve të moshës së tretë.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kujdestarit për të moshuar. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të: - përshkruajë veçoritë e punës së kujdestarit për të moshuar; - përshkruajë karakteristikat e punës së kujdestarit për të moshuar; - përshkruajë mundësitë e punësimit të kujdestarit për të moshuar; - përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit të shërbimeve sociale; - të përshkruajë etikën profesionale të kujdestarit për të moshuar. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim RM 2 Kursanti përcakton rolin, rëndësinë dhe detyrat e kujdestarit për të moshuar në shërbimet sociale për të moshuarit. Kriteret e vlerësimit Kursanti duhet të jetë i aftë të: - përshkruajë veçoritë e punës së kujdestarit për të moshuar; - përcaktojë rolin dhe detyrat e kujdestarit për të moshuar; - përdorë empatinë gjatë ushtrimit të profesionit; - përshkruajë rregullat e marrëdhënies me të moshuarit; - përshkruajë rregullat e komunikimit dhe sjelljes; - respektojë diversitetin dhe kofidencialitetin e individëve me të cilët punon;	

- përshkruajë mënyrën e sjelljes dhe qëndrimit të kujdestarit;
- të identifikojë tipologjinë e shërbimeve sociale për të moshuarit;
- evidentojë funksionet e shërbimeve rezidenciale;
- dallojë funksionin e shtëpisë së të moshuarve;
- evidentojë shërbimet në shtëpi;
- të përshkruajë standartet e shërbimeve sociale në vendin tonë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 3 Kursanti përshkruan ndryshimet specifike gjatë plakjes dhe standartet e kujdesit për të moshuar.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përcaktojë faktorët biologjik të plakjes;
- analizojë ndryshimet sociale në moshën e tretë;
- përcaktojë përkujdesjen sipas rasteve përkatëse;
- përcaktojë kujdesin shëndetësor dhe mjekimin sipas planit individual të klientit;
- të respektojnë të drejtat e të moshuarit;
- respektojë intimitetin dhe dinjitetin e njeriut gjatë shërbimeve personale higjienike;
- respektojë të moshuarin në çastet e fundit të jetës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e kursit Kujdestar për të Moshuar, si dhe mund organizohen vizita pranë qendrave rezidenciale dhe ditore të cilat ofrojnë shërbime social-komunitare për të moshuarit.
- Instruktori duhet të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur kursantin në demonstrimin konkret të çështjeve që trajton.
- Instruktori duhet të krijojë kushtet sa më të përshtatshme në mënyrë që të stimulojë angazhimin e kursantëve.
- Kursanti duhet të angazhohet sa më shumë në veprimtari konkrete për të përshkruar nevojat social-komunitare të të moshuarit në të cilat bazohet aktiviteti i kujdestarit për të moshuar.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis për zhvillimin e orëve teorike.
- Video-projektor.
- Modele të ndryshme të katalogëve që promovojnë shërbime sociale.

- Materiale didaktike, udhëzuesat, rregulloret, etj.

2. Moduli “Vlerësimi i gjëndjes dhe përkujdesja psiko-sociale e të moshuarve”

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VLERËSIMI I GJËNDJES DHE PËRKUJDESJA PSIKO-SOCIALE E TË MOSHUARVE.	KM -02-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson kursantët për zbatimin e planit të kujdesit për jetën sociale, autonominë e zgjedhjes dhe vetëshërbimit të të moshuarve pranë familjeve, qendrave ditore dhe rezidenciale për të moshuarit.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori; 60% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin I “Hyrje në profesionin e kujdestarit për të moshuar”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti planifikon përkujdesjen psiko-sociale të të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të: - kryejë vëzhgimin e të moshuarit; - njohë drejtpërdrejtë të moshuarin; - kryejë vrojtimin e lirë dhe sistematik të të moshuarit; - përcaktojë gjendjen mendore dhe shëndetsore të të moshuarit; - planifikojë përkujdesjen psiko-sociale sipas rasteve përkatëse; - zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje- përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RM 2 Kursanti vlerëson nevojat e të moshuarve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të : - vlerësojë nevojat jetësore të të moshuarit; - vlerësojë nevojat për autonomi; - vlerësojë nevojat sociale të të moshuarit; - vlerësojë nevojat psikologjike të të moshuarit; - vlerësojë nevojat për shoqërim të të moshuarit; - zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RM 3 Kursanti përkujdeset për shëndetin mendor të të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të: - përkujdeset për të moshuarin me Alzheimer;	

- përkujdeset për të moshuarin me depresion;
- përkujdeset për të moshuarin me çrregullime të paranoias;
- përkujdeset për të moshuarin me çrregullime të ankthit, fobitë.
- respektojë të drejtat e të moshuarit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti mbështet të moshuarin për autonomi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- mbështesë të moshuarin në përshtatjen me situatën e re;
- mbështesë vetorganizimin e jetës së të moshuarit;
- nxisë marrjen e vendimeve rreth jetës së përgjithshme dhe aktiviteteve të të moshuarit;
- asistojë në nxitjen e fleksibilitetit gjatë rutinës së përditshme të të moshuarit;
- të planifikojë organizimin e veprimtarive për krijimin e atmosferës pozitive;
- respektojë të drejtat e të moshuarit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti asiston dhe mbështet të moshuarin gjatë ndryshimeve sociale.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- asistojë gjatë kufizimit të roleve sociale të të moshuarit;
- sfidojë diskriminimin negativ të të moshuarit;
- përkujdeset për të moshuarin gjatë dhe pas daljes në pension;
- asistojë të moshuarin gjatë ndryshimeve të gjëndjes financiare;
- përkujdeset gjatë rasteve të braktisjes së të moshuarit;
- përkujdeset gjatë rasteve të braktisjes së detyruar të të moshuarit;
- bashkëpunojë në ridimensionimin e marrdhënieve me familjarët;
- përkujdeset në kapërcimin e humbjeve të të afërmeve të të moshuarit;
- përkujdeset për të moshuarin gjatë fazave të vdekjes;
- respektojë të drejtat e të moshuarit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Kursanti përkujdeset për të moshuarin gjatë dhe pas vdekjes.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- respektojë të drejtat e të moshuarit gjatë vdekjes;
- analizojë problematikat dhe ndihmën gjatë vdekjes;
- komunikojë dhe ndërveprojë me të moshuarin gjatë vdekjes;
- vendosë marrëdhënie të mirëkuptimit dhe besimit reciprok me të moshuarin dhe me familjarët e tij;
- kryejë veprimet pas përcaktimit të vdekjes dhe përkujdesja për të vdekurin.
- të zbatojë rregullat e komunikimit me të afërmit e të moshuarit.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës me mjetet e përshtatshme si nje ambient që ofron shërbime sociale për të moshuar, e simuluar, ose në instucione reale që ofrojnë shërbime rezidenciale ose ditore për të moshuarit.
- Instruktori dhe personeli i qendrës duhet të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur kursantin në procedurat e përditshme konkrete të institucionit që ofron shërbimin, në situata që lidhen me nevoja specifike në rrethana specifike të të moshuarve.
- Instuktori dhe personeli i qendrës duhet të krijojnë kushtet e përshtatshme për kursantët në mënyrë që kursantët të simulohen në të gjitha veprimtaritë e sigurimit të nevojave sociale dhe autonomisë të të moshuarve.
- Kursanti duhet të angazhohen në mënyrë progresive në përkujdesjen ndaj të moshuarve në zbatimin e planit të përkujdesit të të moshuarve, në vlerësimin e nevojave aktuale dhe mundësitë që ofron qendra për përmbushjen e tyre.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore.
 - Mjedise reale të shërbimeve sociale për të moshuarit.
 - Materialet ndihmëse, mjedis për zhvillimin e orëve teorike, materiale didaktike, udhëzuesa,CD, katalogë, rregullore, etj..
-

3. Moduli “Dhënia e ndihmës së parë tek të moshuarit”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	DHËNIA E NDIHMËS SË PARË TEK TË MOSHUARIT.	KM -03-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që e pajis kursantin me aftësi për të dhënë ndihmën e parë në raste fatkeqësish, sëmundjesh akute, aksidentesh dhe të tjera rreziqe për jetën, sipas protokolleve dhe metodave të njohura, si dhe për të evidentuar dhe dokumentuar të dhëna të thjeshta në vendngjarje dhe gjatë transportit deri në qendrën mjekësore më të afërt.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori;70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përfunduar modulën 1 ”Hyrje në profesionin e kujdestarit për të moshuar”; modulën 2” Vlerësimi i gjendjes dhe përkujdesja psiko-sociale e të moshuarve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti vlerëson gjendjen dhe të dhënat shëndetësore të të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të: - përcaktojë shpejt dhe saktë prioritetet e veprimit; - pozicionojë të moshuarin në pozicionin e përshtatshëm; - vlerësojë gjakosjen/hemoragjinë e të moshuarit; - kontrollojë dhe lirojë rrugët e frymëmarrjes; - vlerësojë dëmtimet kockore; - vlerësojë dhimbjet e forta; - vlerësojë ndjenjën e të vjellave; - vlerësojë vështirësinë në frymë-marrje; - vlerësojë rritjen e temperaturës trupore; - zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RM 2 Kursanti vlerëson shenjat jetësore tek i moshuari. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të : - njoftojë urgjencën mjekësore; - vlerësojë gjendjen e komunikimit të të moshuarit; - frymëmarrjen e të moshuarit; - vlerësojë tensionin arterial; - gjejë pulsin në kycin e dorës ose qafën e të moshuarit; - kontrollojë frekuencën, ritmin dhe fortësinë e pulsit tek i moshuari; - zbatojë riaktivizimin e zemres dhe mushkrive; - zbatojë frymëmarrjen gojë-gojë; - sigurojë transportimin sa më të shpejtë dhe komod të të moshuarit;	

- raportojë saktë gjendjen e të moshuarit tek ekipi i urgjencës;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti i jep të moshuarit ndihmën e parë sipas rastit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- japë ndihmën e parë në rast thyerje të kockave;
- japë ndihmën e parë në rast hemoragjie dhe plage;
- japë ndihmën e parë në rast të fikëti;
- japë ndihmën e parë në rast humbje të lëngjeve; (dehidrimi) japë ndihmën e parë në rast helmimi;
- japë ndihmën e parë në rast diegieje;
- japë ndihmën e parë në rast goditje nga rryma elektrike;
- japë ndihmën e parë në rast goditje nga dielli;
- japë ndihmën e parë në rast pickimi nga insektet;
- japë ndihmën e parë në rast miokardit, kome diabetike dhe insulti cerebral;
- dokumentojë të dhëna të thjeshta si; emër/mbiemër, koha e dëmtimit, përshkrimi i ndihmës së dhënë.
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinet i cili të jetë i pajisur me mjetet për ndihmën e parë.
- Instruktori duhet të ilustrojë dhe instruktojë në mënyrë sa më korrekte të gjitha etapat e ndihmës së parë.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të shprehive që trajton moduli.
- Gjatë vlerësimit duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis i bollshëm për kryerjen e të gjitha veprimeve të ndihmës së parë;
 - Pajisje si kukulla mësimore, mjete ndihmëse rrethore për dhënien e ndihmës së parë; –
 - Materiale të ndihmës së parë të fabrikuar/ kutitë e ndihmës së parë;

- Materiale të shkruara, udhëzues, rregullore, etj..

4. Moduli “Përkujdesja personale dhe dhënia e medikamenteve të rekomanduara”

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PERSONALE, ZBATIMI I RREGULLAVE TE HIGJENËS DHE DHËNIA E MEDIKAMENTEVE TË REKOMANDUARA.	KM -04-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të realizuar përkujdesjen trupore në përshtatje me nevojat specifike të moshuarit, i aftëson kursantët për të përgatitur dhe ushqyer të moshuarin në përshtatje me gjendjen e tij shëndetësore, për të kryer zhveshjen, larjen, veshjen e të moshuarëve, si dhe dhënien e medikamenteve të rekomanduara.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përfunduar modulën 1 ”Hyrje në profesionin e kujdestarit për të moshuar”; modulën 2” Vlerësimi i gjendjes dhe përkujdesja psiko-sociale e të moshuarve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti kryen zhveshjen e të moshuarëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të: - lirojnë të gjitha kopsat dhe rripat e veshjeve; - pozicionojë ndenjur të moshuarin; - heqë me kujdes veshjen e sipërme nga qafa; - pozicionojë sinë fillim individin; - heqë një nga një veshjen e poshtme; - regojë kujdes për kokën, duart, këmbët gjatë zhveshjes (në rast kur mund të kenë plagë apo dëmtime); - zbatojnë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit; - zbatojnë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje -përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RM 2 Kursanti përkujdeset për pjesë të ndryshme të trupit të të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të : - përzgjedhë e materialeve dhe mjeteve të punës dhe vendit të punës ku do të kryhet larja; - përkujdeset për sytë, për gojën dhe dhëmbët, për hundën,	

për veshët;

- përkujdeset për flokët , për mjekrën dhe rruajtja;
- përkujdeset për duart, këmbët dhe thonjtë, për zonën intime;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontroll

RM 3 Kursanti kryen larjen e të moshuarit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përzgjedhë materialet dhe mjetet e duhura të punës;
- përgatitë me kujdes vendin ku do të kryhet larja;
- rregullojë temperaturën e përshtatshme të ujit dhe ajrit;
- informojë të moshuarin në nevojë për procesin;
- pozicionojë saktë të moshuarin në nevojë për larje;
- kryejë zhveshjen e të moshuarit sipas protokollit;
- mbështjellë mirë me peshqir banjoje individin në nevojë;
- përdorë saktë legenin e shtratit;
- kryejë larjen dhe tharjen e flokëve;
- kryejë larjen dhe tharjen e fytyrës;
- kryejë larjen dhe tharjen e gjymtyrëve të sipërme e të poshtme;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti kryen veshjen e të moshuarit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- vendosë bluzën përpara njeriut në nevojë të bëjë futjen me kujdes të krahëve të dëmtuar/paralizuar;
- bëjë me kujdes futjen e kokës në bluzë;
- kryejë veshjen e bluzës plotësisht duke patur kujdes mos shkaktojë lëndime;
- mbështetet tek vetëndihma e njeriut në nevojë;
- kryejë në fillim veshjen e këmbës së dëmtuar, të paralizuar ose me plagë;
- shtrijë plotësisht pantallonin për të mos krijuar rrudha dhe pala;
- kontrollojë vazhdimisht derrat dhe kateteret për të mos dëmtuar fu pampersave tek të sëmurët me inkontinencë;
- kryejë pozicionimin dhe sistemin special të të moshuarit.
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;

- të zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti zbaton rregullat e higjienës për parandalimin e infeksioneve.

Kriteret e vlerësimit:

- Kursanti duhet të jetë i aftë të:
- zbatojë masat e desinfektimit higjienik të duarve para dhe pas shërndarjes së ushqimit , medikamenteve, si dhe ndërmjet veprimeve të ndryshme përkudësëse;
- pastrojë sendet që përdorë i moshuari;
- pastrojë orenditë e ambjentit të banimit;
- dezinfektojë mjetet dhe materialet ndihmëse;
- dezinfektojë mjedisin dhe pajisjet hidrosanitare;
- zbatojë rregullat e veshjes dhe higjienën e uniformës së punës;
- trajtojë materiale septike dhe aseptike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Kursanti ushqen të moshuarin.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- servirë ushqimin e përgatitur për të moshuarin
- përcaktojë radhën e ushqyerjes sipas dëshirës së të moshuarit
- krijojë mundësinë që i moshuari të ushqehet vetë;
- ushqejë të moshuarin në rast pamundësie totale të tij
- vrojtojë vetëdijen dhe problemet gjatë gëlltitjes;
- pastrojë dhëmbët dhe gojën e individit në nevojë
- akomodojë njeriun në nevojë në pozicionin e mëparshëm;
- ajrosë dhe rregullojë dhomën;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 7 Kursanti i jep të moshuarit medikamentet e rekomanduara.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- kryejë e identifikimin e vlerave ligjore dhe karakteristikave dalluese të recetës mjekësore;
- lexojë me përpikmëri formën dhe dozimin;

- zbatojë me korrektësi mënyrën e përdorimit të barnave;
- sqarojë të moshuarin në nevojë në rast paqartësie;
- kryejë e identifikimin dhe reagimin në rast të efekteve të padëshiruara të barnave;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinet kujdesi social-shëndetësor , në spitale dhe në shtëpi për të moshuar dhe qendra ditore .
- Instruktori duhet të zotërojë dhe instruktojë në mënyrë sa më të saktë të gjitha etapat e përgatitjes dhe dhënies së ushqimit.
- Instruktori duhet të zotërojë dhe instruktojë në mënyrë sa më të saktë të gjitha etapat e përgatitjes dhe kujdesit trupor.
- Instruktori duhet të kryejë demonstrime të sakta praktike për zhveshjen, larjen dhe veshjen e të moshuarit dhe profilaksinë infeksioneve mikrobiale.
- Kursanti duhet duhet përfshihet sa më shumë gjatë procesit të ushqyerjes dhe të zhveshjes, larjes dhe veshjes së të moshuarit, fillimisht duke ndihmuar deri në realizimin e plotë prej tij të gjithë procesit të ushqyerjes.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive dhe aftësive të fituara. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Kabinet kujdesi social-shëndetësor, spitale, shtëpi për të moshuar etj.
 - Komplet pjatash, tasa, gota, lugë, pirunj, thika, pipa.
 - Peceta, peshqirë, tavolina shtrati, jastëk etj.
 - Ujë, solucion larës.
 - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për zhveshjen, larjen, dhe veshjen e të moshuarit në nevojë social-shëndetësore.
 - Të moshuar në nevojë social-shëndetësore ose manekinë.
 - Udhëzues, rregullore, etj.
-

5. Moduli “Zbatimi i rregullave të higjienës, pozicionimi dhe lëvizja e të moshuarit”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	POZICIONIMI , LËVIZJA E TË MOSHUARIT DHE GJIMNASTIKA SHËRUESE.	KM -05-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me aftësi praktike për zbatimin e masave dhe rregullave të higjienës, pozicionimin dhe parandalimin e kontrakturave, dekubitusit, pneumonive, trombozave, si dhe lëvizja e të moshuarit, si dhe zbatimin e gjimnastikës dhe procedurave të rekomanduara.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1 ”Hyrje në profesionin e kujdestarit për të moshuar”; Modulin 2” Vlerësimi i gjëndjes dhe përkujdesja psiko-sociale e të moshuarve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti pozicionon të moshuarin për parandalimin e dekubitusit dhe kontrakturave. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të : - përgatitë vendin e punës; - kryejë lehtësimin e zonave të shtypjes duke zbatuar procedurat përkatëse; - bëjë eliminimin e lagështirës; - kryejë përmirësimin e gjendjes së përgjithëshme duke zbatuar procedurat përkatëse; - zbatojë masat higjienike personale dhe intime; - stimulojë funksionin e qarkullimit të gjakut; - zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit; - bëjë pozicionimin korrekt të trupit të të moshuarit; - kryejë saktë ushtrimet e hershme të kyceve; - kryejë ushtrimet lëvizore të kyceve në të gjitha procedurat e përkujdesjes; - kryejë e terapinë e lëvizjes së përcaktuar për kycet e kontraktuara; - zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit; - zbatojë rregullat e etikës profesionale. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontroll RM 2 Kursanti pozicionon të moshuarin për parandalimin e pneumonive dhe trombozave. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të: - përgatitë vendin e punës;	

- bëjë pozicionimin korrekt të të gjithë trupit të moshuarit sipas procedurave përkatëse;
- kryejë veprimet e duhura për përmirësimin e ventilimit të mushkërive;
- kryejë veprimet e duhura për parandalimin e grumbullimit të sekrecioneve;
- kryejë veprimet e duhura për parandalimin e aspirimit/thithjes;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit
- përgatitë vendin e punës;
- bëjë pozicionimin korrekt të të gjithë trupit të të moshuarit, sipas procedurave përkatëse;
- kryejë veprimet për stimulimin e qarkullimit të gjakut sipas procedurës përkatëse;
- kryejë veprimet për komprimimin/shtrëngimin e venave sipas procedurave përkatëse;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti zbaton gjimnastikën dhe procedura rehabilituese.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përdorë kompresë të ftohta dhe të ngrohta;
- përdorë fashaturat;
- kryejë identifikimin e efekteve të pa dëshiruara të procedurave të rekomanduara;
- kryejë masazhimin e gjymtyrëve gjatë larjes;
- kryerjë lëvizje të plota të kyçeve gjatë larjes dhe gjatë përgatitjes së shtratit;
- kryejë lëvizje aktive izometrike dhe izotonike;
- kontrollojë gjendjen shpirtërore, pulsën dhe frymëmarrjen;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në spitale, klinika, shtëpi për të moshuar
- Instruktori duhet të demonstrojë saktë profilaksinë e dekubituesit, kontrakturave, pneumonive si dhe trombozave tek i moshuari.
- Kursantët duhet të angazhohen në punë konkrete në të gjitha masat profilaktike të lartpërmendura.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi

	i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi, njerzit e moshuar, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Spitale, klinika, shtëpi për të moshuar etj - Materialet ndihmëse për përkujdesje dhe artikuj sanitarë - Udhëzues, katalogë, rregullore, etj

6. Moduli “Përkujdesja për të moshuarit në banesë, pranë familjeve”.

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PËR TË MOSHUARIT NË BANESË, PRANË FAMILJEVE.	KM-06-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson kursantët mbi përcaktimin e rolit dhe të përkujdeses për të moshuarin në shërbimet familjare.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 40% Teori; 50% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1” ”Hyrje në profesionin e kujdestarit për të moshuar ”; Modulin 2” Vlerësimi i gjëndjes dhe përkujdesja psiko-sociale e të moshuarve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përcakton rolin dhe rëndësinë e shërbimit të përkujdesjes në familje. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të: - evidentojë qëllimin e “shërbimit të përkujdesjes në familje”; - identifikojë tipologjinë e shërbimeve në shtëpi; - kuptojë rëndësinë e të hyrit në shtëpinë e tjetrit; - identifikojë zakonet dhe stilin e jetesës; - realizojë marrdhënie me në qendër nevojat dhe kërkesat e të tjerëve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RM 2 Kursanti planifikon përkujdesjen në familjen e të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të :	

- identifikojë kushtet e personit të moshuar;
- evidentojë rëndësinë e “plakjes në shtëpi”;
- evidentojë problemet në marrëdhëniet me të moshuarin;
- planifikojë dhe administrojë kohën gatë shërbimit në familje.
- **Instrumentet e vlerësimit:**
- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti kujdeset për të moshuarin në familje.

Kriteret e vlerësimit.

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- bashkëpunojë me të moshuarin;
- bashkëpunojë me familjarët e të moshuarit;
- kryejë shoqërizimin e të moshuarit;
- asistojë të moshuarin në aktivitetet e përditshme;
- shmangë faktorët stresantë dhe emocionet e forta të të moshuarit;
- përkujdeset për higjenën vetiake të të moshuari;
- realizojë sigurimin e higjenës së përditshme dhe të ambientit ku jeton i moshuari;
- zbatojë rregullat për parandalimin e rreziqeve;
- sigurojë asistimin gjatë lëvizjes të të moshuarit;
- konsultojë dhe kujdeset për ushqimin e të moshuarve;
- kontrollojë dhe asistojë të moshuarin në marrjen e ilaceve;
- përdorë kutinë e ndihmës së shpejtë sipas rasteve;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të moshuarit.
- **Instrumentet e vlerësimit:**
- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në familje.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë teorike dhe në shërbime pranë familjeve.
- Instruktori dhe familjarët duhet të përfshijnë sa më shumë të jetë e mundur kursantin në procedurat e përditshme konkrete , situata që lidhen me nevoja specifike në rrethana specifike të të moshuarve.
- Instruktori dhe personeli i qendrës duhet të krijojnë kushtet e përshtatshme për kursantët në mënyrë që ata të simulojnë angazhimin e kursantëve në të gjitha veprimtaritë e sigurimit të nevojave sociale dhe autonomisë së të moshuarve.
- Instruktori dhe personeli duhet të demonstrojnë korrektësi përkushtim për përkujdesjen ndaj të moshuarve.
- Kursanti duhet të angazhohen në mënyrë progresive në përkujdesjen ndaj të moshuarve në zbatimin e planit të përkujdesit të të moshuarve.
- Vlerësimin e nevojave aktuale dhe mundësitë që ofron qendra për përmbushjen e tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.	
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me qendra që ofrojnë shërbime sociale për moshën e tretë, qendrat rezidenciale dhe ditore, shtëpitë e të moshuarve, bizneset sociale si dhe direkt në familje. - Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në qendra që ofrojnë shërbime sociale për të moshuarit, qendra rezidenciale dhe ditore , biznese sociale, si dhe direkt në familjet e personave të moshuar . - Materialet ndihmëse, mjedis për zhvillimin e orëve teorike, materiale didaktike, udhëzues, CD, katalogë, rregullore, etj.